



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Nr.18 Tiranë

Tel/Fax: 04 2268141; 2268142

Nr. 105 Prot.

Tiranë, më 10.02.2017

**V E N D I M**

**Nr. 27, datë 10.02.2017**

***“Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr.151, datë 05.12.2016 dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 22.07.2016 e në vazhdim”***

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil mbikëqyr, kryesisht ose me kërkesë të institucioneve, zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civil, nxjerr vendime paralajmëruese në rast se konstaton parregullsi dhe përcakton detyra konkrete për rregullimin e situatës.

Për këtë arsye:

Në zbatim të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenet 11/1 dhe 14 , të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenit 34 e vijues të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me qëllim verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna në Vendimin paralajmërues nr. 151, datë 05.12.2016, të Komisionerit, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera gjatë realizimit të procedurave për rekrutim, transferim, ngritje në detyrë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, prej datës 22.07.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes*) e në vazhdim,

**VENDOSA:**

1. Fillimin e verifikimit të zbatimit të Vendimit nr. 151, datë 05.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”.
2. Verifikimin e akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin Prefekti i Qarkut Shkodër, prej datës 22.07.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim,

sipas objektit dhe aneksit që përmban Programi i Verifikimit, i cili është pjesë e këtij vendimi.

3. Ngritjen e grupit të punës, me këtë përbërje:

- |                          |  |
|--------------------------|--|
| <b>1. Altin Shumeli</b>  | Drejtor i Mbikëqyrjes  |
| <b>2. Zamira Mujali</b>  | Inspektore, Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ          |
| <b>3. Ilir Osmanlliu</b> | Specialist, Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë |

4. Ky proces do të fillojë me paraqitjen e grupit të punës në subjekt, në datën **06.03.2017** dhe do të përfundojë më datën **23.03.2017**.

5. Me përfundimin e verifikimit të akteve, grumbullimit të dokumentacionit dhe të dhënave në subjekt, grupi i punës, do të vijojë punën me përpunimin e të dhënave. Aktet e konstatimit, procesverbalet e mbajtura në subjekt si dhe dokumentacioni i administruar, lidhur me zbatimin e vendimit të Komisionerit dhe verifikimin e ligjshmërisë së emërimeve të kryera nga institucioni, do t'i paraqiten për të vijuar procesin respektivisht Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, brenda datës **07.03.2017**. Relacionet përkatëse duhet të përpilohen deri në datën **20.03.2017**. Më pas do t'i paraqiten për miratim Komisionerit, dhe më tej, do të hartohen vendimet për përmbylljen e proceseve, brenda **3** ditëve.

6. Vendimi përfundimtar dhe vendimi paralajmëruar i Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për përmbylljen e procedimit administrativ (*verifikimit*) do t'i dërgohet subjektit të mbikëqyrur Prefekti i Qarkut Shkodër, Njësisë Përgjegjëse (*Departamentit të Administratës Publike*) dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme.

7. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit dhe Drejtoria e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, që të marrin masat për realizimin e procesit, duke filluar me njoftimin e subjektit që do t'i nënshtrohet mbikëqyrjes në përputhje me nenin 42, të Kodit të Procedurave Administrative dhe të akteve që janë pjesë e këtij vendimi.

8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi Zogu I-rë, Godina 57, shk.2, Nr.18. Tiranë

Tel: 355 4 2268 142; Fax: 355 4 2268 141

Nr. 105/1 Prot.

Tiranë, 10.02.2017

**M I R A T O H E T**

**Pranvera STRAKOSHA**

**KOMISIONER**

**PROGRAM VERIFIKIMI**

*(Për verifikimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit nr. 151, datë 05/12/2016, dhe ligjshmërinë e veprimeve administrative të kryera nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër, gjatë procesit të emërimeve, të kryera prej datës 22.07.2016 e në vazhdim).*

- 1. Subjekti i mbikëqyrjes:** **Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër**
- 2. Objekti i verifikimit:** Zbatimi i Vendimit paralajmërues nr. 151, datë 05.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.  
  
Verifikimi i akteve të emërimit, të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mosrespektuar procedurat e rekrutimit, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, prej datës 22.07.2016 (momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil gjatë mbikëqyrjes) e në vazhdim.
- 3. Baza ligjore:** Neni 14, i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe neni 34 e vijues i Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me

Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

**4. Periudha e verifikimit:**

Fillon me datën e daljes së Vendimit paralajmërues të Komisionerit nr. 151, datë 05.12.2016 “*Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë*”, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi dhe në datën e përfundimit të mbikëqyrjes në subjekt (22.07.2016), për rastet e emërimeve në kundërshtim me ligjin.

**5. Afati i verifikimit:**

Verifikimi do të fillojë në institucion në datën **06.03.2017** dhe do të përfundojë brenda datës **23.03.2017**.

**6. Procedura që do të ndiqet:**

Për parregullsitë e konstatuara do të mbahen aktet e konstatimit, procesverbal administrativ, të cilët do të nënshkruhen nga grupi i verifikimit dhe personat përgjegjës, si dhe do të merret kopja e dokumentacionit përkatës, vërtetuar nga sekretaria e institucionit.

**7. Grupi i punës:**

- 1. Altin Shumeli** Drejtor i Mbikëqyrjes
- 2. Zamira Mujali** Inspektore, Drejtorja e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ
- 3. Ilir Osmanlliu** Specialist, Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë

**8. Dokumentimi i rezultateve të verifikimit:**

Në përfundim të procesit të verifikimit dhe mbikëqyrjes do të përgatiten relacionet përkatëse nga Drejtorja e Çështjeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë, dhe Drejtorja e Përgjithshme e Mbikëqyrjes dhe Inspektimit, bazuar në aktet e konstatimit dhe procesverbalet e mbajtuara në subjektin e verifikuar si dhe do të administrohet dokumentacioni provues. Më pas do të hartohet vendimi përfundimtar i procedurave përmbyllëse të verifikimit të zbatimit të vendimit, i cili do të dërgohet institucionit (*n.q.s vendimi nuk është zbatuar, Komisioneri do të zbatojë kompetencën e parashikuar në nenin 15, pika 2, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar*) dhe vendimi paralajmërues në përfundim të verifikimit të ligjshmërisë së veprimeve administrative lidhur me emërimet e dala në kundërshtim me ligjin.

## DREJTIMET E VERIFIKIMIT

I. Si janë zbatuar, detyrat e lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në Vendimin nr. 151, datë 05.12.2016, “Për miratimin e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes së administrimit të shërbimit civil, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër dhe paralajmërimin e institucionit për të rregulluar gjendjen e ligjshmërisë”, nga ana e Njesisë Përgjegjëse Departamentit të Administratës Publike dhe Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit të mbikëqyrur. Në këtë rast, verifikimi do të realizohet duke pasur parasysh nivelin e zbatimit të urdhërimeve në vendimin paralajmërues, si më poshtë, duke administruar kopje të akteve që materializojnë zbatimin e vendimit:

1. Të miratoj raportin përfundimtar të mbikëqyrjes së përgjithshme në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër, i cili është pjesë e këtij vendimi dhe të paralajmëroj institucionin për të rregulluar situatën e paligjshmërisë në zbatimin e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke kërkuar zbatimin e detyrave që do të specifikohen më poshtë.
2. Për të rregulluar situatën në lidhje me pozicionin e punës “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit të qarkut, me qëllim sqarimin e rolit të tij në skemën e administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP), duhet të përcaktojë kategorinë e shërbimit civil në të cilën klasifikohet ky pozicion, ose pozicionin e barasvlershëm me të, sipas kategorive dhe klasave të parashikuara në nenin 19, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut 2, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar. Ky proces duhet të gjejë pasqyrim edhe në përshkrimin e punës për pozicionin “Sekretar i Përgjithshëm”, në institucionin e prefektit.
3. Të kërkoj nga Sekretari i Përgjithshëm i institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, si organizma që menaxhojnë burimet njerëzore të institucionit, të përfundojnë hartimin e përshkrimeve të reja të punës për të gjitha pozicionet e shërbimit civil, sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në vendimin nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, lidhjeve pjesë e këtij vendimi dhe në përputhje me orientimet që janë dhënë në rubrikën përkatëse të Raportit Përfundimtar të Mbikëqyrjes.

*Institucioni i mbikëqyrur t'i kërkojë Departamentit të Administratës Publike, që të japë zyrtarisht konfirmimin e tij, lidhur me përshkrimet e punës, nëse ato janë të hartuara në bazë dhe në përputhje me legjislacionin specifik të fushës apo formatin standard të miratuar, siç parashikohet në pikën 19, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.*

*Pas marrjes së konfirmimit nga njësia përgjegjëse (DAP), përshkrimet e punës t'i dërgohen Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, për të vijuar procesin me nënshkrimin e tyre në ndarjen përkatëse, siç parashikohet në pikën 18,*

shkronja “c”, të vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Një kopje e përshkrimeve të punës të nënshkruara të bëhen pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

4. Njësia përgjegjëse, Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, për punonjësit \*\*\*\*\*, \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*, duhet të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të nxjerra në kuadër të procedurës së deklarimit të statusit të punësimit si dhe akteve të nxjerra në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, si akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi pozicionet e gjendjes civile, ku këta punonjës ushtrojnë detyrën e tyre, nuk janë pjesë e shërbimit civil, por janë funksione të deleguara.

Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të veprojë si më poshtë:

- Të anulojë aktin nr. 3285/6, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin nr. 517/22, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, të nxjerra për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Përgjegjës i Zyrës së Gjendjes Civile”, në institucionin e Prefektit të Qarkut.
  - Të anulojë aktin nr. 3285/1, datë 30.10.2014, “Akti i deklarimit të statusit të punësimit”, si dhe aktin 517/23, datë 12.04.2016, “Transferim i përhershëm për shkak të ristrukturimit”, për punonjësen \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, për Rrethin Pukë, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër.
  - Të anulojë pjesërisht aktin nr. 3285, datë 30.10.2014, “Verifikim i statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktual”, për pjesën në të cilën refuzohet deklarimi i statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*, me detyrë “Specialist i zyrës së gjendjes civile”, për Malësinë e Madhe, në institucionin e Prefektit të Qarkut Shkodër.
5. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të Prefektit të Qarkut Shkodër, në respektim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, të kryejë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Korrik – Dhjetor 2015, për punonjësit e mëposhtëm:
- \*\*\*\*\*, i cili në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë i emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Kompetencave Vendore”;
  - \*\*\*\*\*, i cili në momentin e kryerjes së vlerësimit ka qenë i emëruar në pozicionin “Specialist i shërbimeve”, në Nënprefekturën e Pukës.

*Në përfundim të procesit, formulari i vlerësimit për nëpunësit e mësipërm, të përfshihet në Regjistrin Qendror të Personelit, siç parashikohet në pikën 18, të Kreut II, të aktit nënligjor si më sipër.*

- 6. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit të mbikëqyrur, në rastin e punonjësve \*\*\*\*\* si dhe në të gjitha rastet e vlerësimit të rezultateve të nëpunësve civilë, me nivelin 4, “Jo kënaqshëm”, të zbatojë dispozitat e ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, duke garantuar trajnime të nevojshme, në kuadër të rritjes së aftësive profesionale të nëpunësve civilë.*
- 7. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit duhet të drejtojë procesin e rregullimit të ligjshmërisë gjatë zhvillimit të ecurisë disiplinore, për masat e marra ndaj nëpunësve \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* , duke u kujdesur që në zbatim të nenit 108 dhe 111, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të konstatojë pavlefshmërinë absolute të akteve të mësipërme, për shkak të mosrespektimit të procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore si dhe rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”.*

*Për ndreqjen e këtyre parregullsive, në zbatim të nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative, institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër duhet të veprojë si më poshtë:*

- Të anulojë pjesërisht urdhrin nr. 72, datë 05.11.2015, të Prefektit të Qarkut Shkodër, në pjesën ku është vendosur marrja e masës disiplinore “Vërejtje”, për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\*.*
  - Të anulojë urdhrin nr. 9, datë 09.02.2016, të Prefektit të Qarkut Shkodër, “Për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje””, për nëpunësen \*\*\*\*\*.*
  - Të fshijë masat disiplinore për nëpunësit \*\*\*\*\* dhe \*\*\*\*\* nga dosja personale dhe regjistri përkatës dhe më tej, të veprojnë sipas orientimeve të dhëna në raportin përfundimtar të mbikëqyrjes.*
- 8. Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore e institucionit të sistemojë dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, duke përfshirë në të, të gjitha dokumentet dhe të dhënat sipas lidhjeve 1 e 2, pjesë e vendimit nr. 117, datë 5.3.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”, si dhe ato që janë deklaruar me mangësi në anekset përkatëse, të cilat janë pjesë e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*
  - 9. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim. Institucioni i mbikëqyrur dhe njësia përgjegjëse, duhet të zbatojnë këtë vendim duke u bazuar në orientimet e dhëna në përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes.*

Në rast të konstatimit të moszbatimit të pjesshëm apo të plotë të vendimit të Komisionerit, do të mbahet procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

**II.** Verifikimi i ligjshmërisë së veprimeve administrative të kryera nga ky institucion, lidhur me emërimet të cilat kanë dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit, duke mos u respektuar procedurat e rekrutimit, duke filluar nga data 22.07.2016 (*momenti i përfundimit të mbledhjes së dokumentacionit nga ana e Komisionerit mbi bazën e të cilave u analizua situata në shërbimin civil*) e në vazhdim. Në rast të konstatimit të veprimeve të parregullta që kanë të bëjnë me këtë institut të ligjit, do të administrohen kopje të akteve, si dhe do të procedohet me procesverbal konstatimi, i cili do të nënshkruhet nga grupi i punës dhe personi përgjegjës.

**Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit.

Në vijim të programit të verifikimit, më poshtë po rendisim aktet që duhet të vihen në dispozicion të grupit të verifikimit për të përfunduar këtë proces.

1. Provat shkresore të cilat vërtetojnë zbatimin e detyrave të lëna nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil me vendimin paralajmërues.
2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e mbikëqyrjes dhe ajo aktuale.
3. Listëpagesat dhe listëprezencat e institucionit, duke filluar nga momenti e mbikëqyrjes së mëparshme deri tek ato aktuale.
4. Aktet administrative të cilat materializojnë emërimet në kundërshtim me ligjin, (aktet e emërimit/ kontratat e përkohshme të punës) pas datës 22.07.2016.
5. Dosjet personale të nëpunësve të emëruar pas verifikimit të kryer në kuadër të mbikëqyrjes.
6. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të verifikimit.

**DREJTORI I PËRGJITHSHËM  
I INSPEKTIMIT DHE MBIKËQYRJES**

**DREJTORI I ÇËSHTJEVE JURIDIKE  
DHE I MARRËDHËNIEVE ME JASHTË**

**Arbana BASHA**

**Enkelejda HEBIBASI**